



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.951/2022

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË- Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar, në konfliktin administrativ, sipas padisë së paditësit S...shpk nga Prishtina të cilin e përfaqëson Blerim Prestreshi dhe Hekuran Haxhimusa nga Shoqëria e Avokatëve SCLR Partners kundër të paditurit Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës në Prishtinë të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me bazë juridike: anulim i vendimit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1270/2017 të datës 02.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 06.10.2022, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar, ankesa e të paditurit Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës në Prishtinë, e datës 05.08.2021, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1270/2017 i datës 02.06.2021, Vërtetohet.

A r s y e t i m

Me Aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës së shkallës së parë, është aprovuar Kërkesëpadia e paditësit, është anuluar vendimi i të paditurit, me nr.ref.AUV 01-126/12 dt.27.03.2012, vendimi 1377 dt.05.04.2012 dhe vendimi nr.4313 dt.11.07.2017, si dhe është obliguar e paditura Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës në Prishtinë, që paditësit t,ia kompensoj shumën prej 113,348.31€ në emër të kundërvlerës së mallit të asgjësuar, krejt këto në afat prej 15 ditësh, nën kërcnim të ekzekutimit me dhunë.

Kundër këtij Aktgjykimi, përfaqësuesja e autorizuar e të paditurit, ka ushtruar ankesë me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshohet Aktvendimi A.nr.1270/17 dt.02.06.2021, të refuzohet kërkespadia e paditësit dhe të mbetet në fuqi vendimi i të paditurit. Gjykata gjatë shqyrtimit të qështjes juridike nuk i ka konstatuar fare faktet e rëndësishme për zgjedhjen e qështjes, gjykata është dashur ta shqyrtoj kërkesën e paditësit për lejimin e importit të produktit ushqimor me prejardhje shtazore. Me datë 26.03.2012 te e paditura ka arrit konfirmimi nga autoriteti i SHBA (USA FSIS) me nr.protok.1214 i cili konfirmoj se dokumenti veterinar-qertifikata veterinare me nr.Mpi-..... është i falsifikuar dhe nuk është i lëshuar nga autoriteti i SHBA-së, verifikimi ka arritur me ndërmjetsimin e Ambasadës Amerikane në Sofje-Bullgari nga atasheu për bujqësi. Certifikata veterinare në bazë të numrit është dedikuar për shtetin e Meksikës

dhe produkti nga kjo qertifikate është eksportuar në Meksikë në muajin shkurt 2012. Nga kjo rezulton se produkti i paraqitur per import nuk posedon qertifikate veterinare te dedikuar për Kosovë, por është e falsifikuar dhe si rezultat i kësaj e paditura ka vepruar drejt me rastin e asgjësimit të produktit që konsiderohet mall me rrezikshmëri të lartë për shëndetin publik.

Paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar në përgjigjen në padi dt.10.09.2021 deklaroi se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejt kur ka aprovuar padin dhe kërkespadin e paditësit si të bazuar. Paditësi kundërshton pretendimet e paditures në ankes, sepse janë tërësisht të pabazuara pasi që gjykata e shkallës së parë e ka arsyetuar qartë vendimin e saj duke u mbështetur në të gjitha provat e prezantuar nga palët në procedurë, qartë është vërtetuar gjendje e fakteve duke u bazuar në faktin se e paditura ka asgjësuar mallin pa bërë analiza përkundër faktit se kanë marrë mostrat e produktit të cilin e kanë asgjësuar nën supozimin se malli paraqet rrezikshmëri të lartë për konsumatorë. E paditura nuk ka marrë pjesë në seanca dhe nuk ka dhënë asnjë argument lidhur me pretendimin se gjykata ka vërtetuar gabisht gjendjen e fakteve. I propozojm gjykatës që ta refuzoj si të pabazuar ankesën e të autorizuarit të paditurit, dhe ta vërtetoj Aktgjykimin A.nr.1270/17 dt.02.06.2021

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, shqyrtoi shkresat e lëndës aktgjykimin e ankimuar pretendimet në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49 të LKA, dhe neni 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, (LPK), i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me Aktgjykimin A.nr.587/12 dt.11.05.2017 Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për qështje administrative, ka aprovuar kërkespadin e paditësit, ka anuluar vendimin e të paditurit nr.protok.1377 dt.05.04.2012 dhe qështjen e ka kthyer të paditures në rishqyrtim dhe rivendosje. Ndaj këtij aktgjykimi pala e paditur ka ushtruar ankes, dhe me Aktgjykimin AA.nr.308/2017 dt.01.02.2018 Gjykata e Apelit të Kosovës ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurit Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë në Prishtinë, dhe ka vërtetuar Aktgjykimin A.nr.587/12 dt.11.05.2017 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për qështje administrative

E paditura në rivendosje, duke vepruar sipas Aktgjykimit A.nr.587/12 dt.11.05.2017 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për qështje administrative, ka vërtetuar vendimin e Komisionit të Agjencis së Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës në Prishtinë, nr.1377 dt.05.04.2012, me të cilin është refuzuar ankesa e Kompanis S...në Prishtinë të ushtruar kundër vendimit nr.ref.AUV 01-126/12 nr.protok.1244 dt.27.03.2012 të AUV-Inspektori veterinar kufitar, për asgjësimin e produktit ushqimor me origjinë shtazore, për shkak të falsifikimit të dokumentacionit për import.

Kundër vendimit të paditurit, paditësi inicon përsëri konflikt administrativ, me padi i drejtohet gjykatës. Gjykata e shkallës së parë, në këtë çështje juridike administrative, me dt.02.06.2021, mban seancë të shqyrtimit kryesor në prani të autorizuarit të palës paditëse, e në mungesë të autorizuarit të palës së paditur, e ftuar në mënyrë të rregullt, dhe pas administrimit të provave, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e aprovon Kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, e anulon vendimin e organit të paditur me nr.ref.AUV 01-126/12 dt.27.03.2012, vendimin 1377 dt.05.04.2012 dhe vendimin nr.4313 dt.11.07.2017, si dhe është obliguar e paditura Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës në Prishtinë, që paditësit t,ia kompensoj shumën prej

113,348.31€ në emër të kundërvlerës së mallit të asgjësuar, krejt këto në afat prej 15 ditësh, nën kërcnim të ekzekutimit me dhunë.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të vendimit është referuar në dispozitat e nenit 10, 17 dhe 23 paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-016 për Ushqimin, si dhe neni 18,19 dhe 21 të Rregullores nr.10/2011 për Kontrollin zyrtar të ndërmarrja për të siguruar verifikimin e përputhshmërisë me Ligjin për ushqimin dhe ushqimin për kafshë dhe Rregullat për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve. Gjykata ka dhënë konstatimin se e paditura përkundër faktit se ka marr mostrat për kryerjen e analizave, mirëpo as në procedurën administrative e as me rastin e kthimit të lëndës nga gjykata në rivendosje, e njëjta nuk ka provuar se ka siguruar rezultatet e analizave laboratorike nga mostrat e produkteve të marra, veprim ky që parashihet me dispozitat ligjore të lartcekura. Padiyesi ka bashkangjitur qertifikatën origjinale të produktit të dërguar nga eksportuesi i mallit pasi që ka rezultuar që qertifikata e parë nuk i takon këtij importi, dhe i njëjti ka bërë kërkesë me datë 05.04.2012 për kthimin e mallit dërguesit-eksportuesit të mallit i cili me konfirmimin e datës 04.04.2012 ka pranuar ti kthehet malli kontestues. Kompensimin e dëmit të shkaktuar padiutës për mallin e asgjësuar nga e paditura, gjykata e shkallës së parë e ka bazuar në dispozitën e nenit 17 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative dhe në ekspertizën financiare datë 26.04.2021, e realizuar dhe administruar si provë gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Për shkak të metave të cekura më lartë, gjykata e shkallës së parë, anulon vendimet e të paditurit dhe e obligon që në emër të kompensimit të dëmit material përkatësisht vlerës së mallit të asgjësuar, t,ia kompensoj padiutës shumën prej 113,348.31€.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe konstaton se gjykata e shkallës së parë, drejt ka zbatuar dispozitat ligjore të LKA-së, dhe LPA-së, kur anulon vendimin e atakuar me padi, sepse përmban të meta esenciale, për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij, si në vështrim të nenit 84 par.2 të LPA-së. Njëjtë si gjykata e shkallës së parë edhe Kolegji, vlerëson se vendimi kontestues i të paditurit, nuk është nxjerrë sipas formës dhe përmbajtjes si parashihet, në nenet 84 të LPA-së. I njëjti vendim nuk përmban përmbledhje të konstatimeve faktike bazuar provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ dhe vërejtjeve të dhëna në rivendosje nga Gjykata me Aktgjykimin A.nr.587/12 dt.11.05.2017.

Pretendimet ankimore të paditurës, nga shkaqet ankimore të cekura si më lartë, si dhe theksimet e tjera si në arsyetim të ankesës, Kolegji i refuzon si të pa bazuara, jo të qëndrueshme dhe pa ndikim për vendosjen ndryshe të çështjes, sepse është fakt i pa mohueshëm se mënyra e vendosjes si në dispozitiv të vendimit kontestues nr.4313 dt.11.07.2017, nga e paditura duke vepruar në rivendosje, sipas vërejtjeve dhe rekomandimeve të Gjykatës me Aktgjykimin A.nr.587/12 dt.11.05.2017, është e papranueshme dhe në kundërshtim me ligjin.

Një arsyetim i tillë i vendimit kontestues, edhe pse e paditura ka qenë e obliguar të veproj sipas pikpamjeve juridike dhe vërejtjeve të Aktgjykimit A.nr.587/12 dt.11.05.2017, të kësaj Gjykate, (neni 65 i LKA-së), e paditura ka nxjerr vendim të ri në rivendosje duke mos ndërmarr asnjë veprim ligjor, që të bëhet verifikimi i konfirmimit të dërguesit të mallit se i njëjti pranon ti kthehet malli kontestues, i cili veprim lejohet në bazë të nenit 21 të Rregullores nr.10/2011, dhe i është shmangur në tërësi vërejtjeve të gjykatës, që ti respektoj dispozitat ligjore duke vërtetuar gjendjen faktike nga analizat laboratorike të mostrave të marra nga malli kontestues. E paditura në rivendosje, nxjerr vendim të ri, i cili nuk përmban përmbledhje të konstatimeve faktike bazuar në provat e paraqitura dhe të siguruara gjatë procedimit administrativ, vendimi

kontestues nuk përmban fare arsyetim ku duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet e refuzimit të pretendimeve ankimore dhe vërejtjeve të gjykatës, veprime këto që parashihen me dispozitat e nenit 84 paragrafi 2 pika (c) dhe neni 85.1 të Ligjit 02/L-028 për Procedurën Administrative.

Nga një gjendje e tillë faktike nga e cila rezulton se e paditura nuk ka vërtetuar faktet esenciale respektivisht ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike si rezultat i së cilës është aplikuar gabimisht edhe e drejta materiale, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, i vlerëson si të drejta konstatimet e gjykatës së shkallës së parë, e cila tani për herë të dytë në procedurë të konfliktit administrativ, vërteton vetë gjendjen faktike edhe përmes ekspertizës financiare datë 26.04.2021, nga e cila rezulton shuma e kundërvlerës së mallit të asgjësuar nga e paditura në mënyrë të kundërligjshme, dhe zbaton me të drejt dispozitën e nenit 17 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative. Paditësi ka prezantuar para të paditurës dhe gjykatës, certifikatën veterinare origjinale të dërguesit të mallit, pasi që gabimisht është bashkangjitur importit një certifikatë tjetër që ka pasur destinim shtetin e Meksikës. Meqenëse faktet e vërtetuara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për vendosje të merituar të çështjes, Kolegji, vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe ligjor dhe për shkak të metave të cekura si më lartë, me të drejt është anuluar vendimi i të paditurit, dhe është obliguar si në dispozitiv të aktvendimit kontestues.

Andaj, pasi që me thëniet në ankesë, aktgjykimi si i tillë nuk vihet në pyetje, ankesa e të paditurit refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë vërtetohet si i drejtë dhe ligjor.

Nga të lartë cekurat, e në vështrim 49 të LKA, dhe neni 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË
Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.951/2022 datë 06.10.2022

Kryetari i kolegjit-gjyqtari,
Krenar Berisha